



Prishtinë: 29.03.2018
Kodi i ZRRE-së: V_962_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1744_12_17**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **01.03.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit K.U., nga Prizreni me shifër DPZ 6643 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1744_12_17** i datës 11.12.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 03.11.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori K. U., i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të dispozitave. Konsumatori në ankesë ka theksuar se sipas transaksioneve të konsumatorit vërtetohet se leximi i njehsorit elektrik ka qenë jo i rregullt dhe se si rezultat i kësaj ka ardhur deri te grumbullimi i kWh dhe të njëjtit janë faturuar vetëm për një muaj dhe se për këtë 90% është faturuar me çmimin më të lartë dhe atë në sezonën e dimrit. Konsumatori në vazhdim të ankesës ka theksuar se nuk është e vërtetë se nuk është lejuar çasja e punëtorëve të KEDS për leximin e njehsorit elektrik sepse asnjëherë më parë nuk ka ndodhur një gjë e tillë dhe se çdo herë ka pasur lexim dhe faturim të rregulltë.

Konsumatori në fund ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të prish vendimin e organit të shkallës së parë ashtu që të analizoj historiatin e shpenzimeve dhe të vërtetojë se shpenzimi është bërë në kohën e KEK ndërsa faturimi për një muaj është bërë në kohën e KEDS, si dhe ka kërkuar të lirohet nga pagesa e shumës të cilën nuk e ka borxh.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi ka analizuar të gjitha konstatimet e theksuara nga organi i shkallës së parë lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike, dhe me këtë ka vërtetuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.04674920 prej TL=015819 kWh dhe TU=010637 kWh e evidentuar në procesverbalin nr.0808278 i datës 12.02.2014 është në përputhje me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike për muajin 01/2014. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalet tjera të inspektimit të datave 04.03.2014 dhe 29.03.2014, dhe ka konstatuar se të dhënat e regjistruara në procesverbale sa i përket shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.04674920 përputhen plotësisht me ato të faturuara në periudhën janar dhe shkurt 2014.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, procesverbalit të inspektimit të datës 29.03.2014 dhe rrjedhës së energjisë elektrike aktive, ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjatë inspektimit kanë evidentuar që konsumatori është faturuar pa matje me herët, për shkak se nuk kanë pasur qasje në leximin e pikës matëse, pasi që njehsori elektrik i konsumatorit ka qenë i vendosur në brendi të objektit të konsumatorit dhe se dera ka qenë gjithmonë e mbyllur. Duhet theksuar se mos qasja e punëtorëve të KEDS-it në leximin e shpenzimeve mujore është në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, ku thuhet se: *"1. Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji"*.

Sa i përket pikës së tjetër të kundërshtimit rreth grumbullimit të shpenzimit të energjisë elektrike dhe faturimit të tij në një muaj dhe ajo pastaj është faturuar me çmime të larta dhe atë në sezonën e dimrit. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së konstaton se konsumatori nga periudha dhjetor 2012 deri në periudhën janar 2014 nuk ka lexim të saktë, dhe se për këtë shkak është bërë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorët – kWh) për periudhën 12/2012 deri në periudhën 01/2014 dhe pas shpërndarjes ka rezultuar që konsumatori duhet të korrigjohet në vlerë prej - 322.13€, dhe se këtë korrigjim e ka bërë KESCO me datë 30.04.2014. Pra, Bordi i ZRRE-së konstaton se për shkak të grumbullimit të shpenzimit të energjisë elektrike të muajit 01/2014 është bërë korrigjimi i vlerës së lartcekur dhe se nuk ka elemente tjera të korrigjimit që duhet t'i bëhet konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit K.U. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së